



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Procedurë e Shqyrtimit Number of the Case Case No. of the Party	24. 02 22	2	2022
Emri i Komunitetit City of the Party	SKAMSHICK	987/2022	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.11/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.11/2022 të datës 11.01.2022 të parashtruar nga ankuesit

te cilët me me
adresë Lagjja Kalabria, Rruga: Komuna e Prishtinës, kundër
organit të punësimit/Inspektorati Policor i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.11/2022 e datës 11.01.2022 e parashtruar nga ankuesit

dhe

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.11/2022 e datës 11.01.2022 e parashtruar nga anku

A r s y e t i m

Ankuesit sipas vërtetimit të datës 17.11.2021 me numër 73/2021 vazhdon të punoj si "Hetues", sipas kontratë pune për kohë të caktuar/të pacaktuar të datës 08.06.2017 është e sistemuar në vendin punës "Inspektore", sipas kontratë pune për kohë të caktuar/ pa caktuar është e sistemuar në vendin e punës "Hetuese"; sipas vërtetimit të datës 18.11.2021 vazhdon të punoj si Ushtrues i Detyrës i Udhëheqësit të Divizionit Jugor i Hetimit të Krimeve të Përgjithshme në Departamentin e Hetimeve" sipas Vërtetimit me Nr.81/2021 të datës 18.11.2021 vazhdon të punojë si "Ushtrues i Detyrës i Udhëheqësit të Divizionit Verior i Hetimeve të Krimeve të Përgjithshme në Departamentin e Hetimeve IPK"; sipas akt emërimit të datës 16.10.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Receptionist" dhe sipas kontratës së datës 08.06.2017 për kohë të caktuar është i sistemuar në vendin e punës "Hetues".

Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, më datë 24.12.2021 është përgjigjur në kërkesën e ankuesve duke i njoftuar që këto pagesa nuk janë bërë për shkak që ministrinë e linjës nuk i kanë ndarë mjetet për këto kategori.

Ankuesit, kundër kësaj përgjigje, përmes përfaqësuesit të tyre, më datë 11.01.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 53/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 11.01.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 24.12.2021; Kërkesën e ankuesve të datës 09.12.2021; Autorizimet e ankuesve për përfaqësim të Avokatit Akt emërimi i Akt emërimi i

Akt emërimi	Vërtetimi i datës 18.11.2021 i	Vërtetimi i
datës 17.11.2021 i	Vërtetimi i datës 18.11.2021 i	Kontrata e punës
e	Kontrata e punës	Akt emërimi i
emërimi i	Akt emërimi i	Akt emërimi i
Vërtetimi i datës 16.11.2021 i	Akt emërimi i	Vërtetimi i datës
15.11.2021 i	Vërtetimi i datës 16.11.2021 për	Vërtetimit të datës
16.11.2021 për	Vërtetimi i datës 17.11.2021 për	Akt emërimi i
Vërtetimi i datës 15.11.2021 për	Akt emërimi i	Ihe
Vërtetimi i datës 16.11.2021 për		

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën I të dispozitivit, sepse:

Bazuar në të gjitha provat e lëndës konkretisht në Kontratën e Punës për Kohët të Caktuar/të Pacaktuar për ankuesit si në pikën e parë I të dispozitivit të këtij vendimi, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se këta ankues mbajnë pozita Ushtrues të



detyrës së "Udhëheqësit të Divizionit Jugor i Hetimit të Krimeve të Përgjithshme në Departamentin e Hetimeve", "Hetues", "Inspektor", dhe "Receptionit". Referuar dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës gjegjësisht neni 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ka përcaktuar se: *"Personeli i IPK-së ndahet në katër kategori: 1.1. hetuesit; 1.2. inspektorët"*, ndërsa për punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës të punësuar si "Udhëheqësit të Divizionit Jugor i Hetimit të Krimeve të Përgjithshme në Departamentin e Hetimeve", "Hetues", "Inspektor", dhe "Receptionit", të cilët kanë autorizime policore dhe operative, marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me akt nënligjor, siç përcaktohet me nenin 16 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, ku thuhet që: *"Procedura, kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK-së rregullohen me akt nënligjor nga Ministri, që përfshin por nuk do të kufizohet edhe në ngritjen në karrierë, trajnimin dhe konfliktin e interesit"*. Po ashtu me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.01/2017 për Procedurat Lidhur me Kushtet e Punësimit dhe të Punës për Punonjësit e IPK-së, përcaktohet që: *"Punonjësi operativ i IPK-së-nënkupton punonjësin që ka kompetencë hetimore apo inspektuese dhe është i sistemuar në njërin nga departamentet operative"*, rrjedhimisht mbi bazë të kësaj punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës të punësuar si "Udhëheqësit të Divizionit Jugor i Hetimit të Krimeve të Përgjithshme në Departamentin e Hetimeve", "Hetues", "Inspektor", dhe "Receptionit", nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, sepse statusin e nëpunësit civilë në Inspektoratin Policor të Kosovës e kanë vetëm punonjësit e personelit mbështetës të IPK-së, të cilët nuk kanë kompetencë hetimore dhe inspektuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2017 për Procedurat Lidhur me Kushtet e Punësimit dhe të Punës për Punonjësit e IPK-së, ku thuhet që *"Punonjës në personelin mbështetës-nënkupton punonjësin e punësuar në IPK sipas Ligjit për Shërbimin Civil, që nuk ka kompetencë hetimore apo inspektuese, por që me punën e tij mbështet funksionet kryesore të IPK-së në aspektin administrativ e teknik"*, rrjedhimisht i punësuar në venin e punës "Receptionit" ofrojnë shërbime administrative teknike që janë të përjashtuar edhe nga Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik të përcaktuar sipas neni 2 paragrafi 6 që ka përcaktuar se: *"Nëpunës administrativo-teknik-dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 3 paragrafi 1, ka përcaktuar që: *"Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë"*, ndërsa paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 i këtij ligjit ka përcaktuar që: *"Funksionarë publikë me status të veçantë, në kuptimin e nën paragrafit 1.2 të këtij neni janë: 3.3. zyrtarët policor të Kosovës dhe inspektorati policor i Kosovës"*, mbi bazë të kësaj konstatohet që ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civil, këtë e ka vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin për rastin nr. KO203/19 të datës 09.07.2020 lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Bazuar në këtë sipas paragrafit 4 të neni 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet që: *"Marrëdhënia ndërmjet shtetit dhe funksionarit publik me status të veçantë, të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, rregullohet tërësisht me ligj të veçantë sektorial"*, si rrjedhojë duke ju referuar dispozitave të neni 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048

për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Po ashtu bazuar në vendimmarrjen e mëparshme Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës të punësuar si *Hetues dhe Inspektor*, për të cilët është shpall jo kompetent ka vendosur edhe Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykim A.nr.1589/2017, Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin AA.nr.387/2018 dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.116/2019, me të cilat është vërtetuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në provat e lëndës për ankuesit, sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare e Pasurisë", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare e Pranimit", sipas akt emërimit të datës 10.04.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtare për Përkthim", sipas akt emërimit të datës 06.10.2017 është e sistemuar në vendin e punës "Arkëtar", sipas akt emërimit të datës 03.06.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Asistent Administrativ", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare Certifikuese", sipas akt emërimit të datës 03.06.2019 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare për Arkiv", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare Zotuese", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa", sipas akt emërimit të datës 14.06.2019 është i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Personelit", sipas akt emërimit është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtare për Lektorim", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme", sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është i sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Transportit" dhe sipas akt emërimit të datës 30.01.2018 është e sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Shpenzimeve", të cilët me datë 09.12.2021 kanë parashtruar kërkesën tek Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës për kompensimin e rrezikshmërisë në punës, për pagat, shtesat dhe dobitë e tjera, harmonizimin e koeficienteve në bazë të ngritjes akademike nga ai universitar deri në nivel master si dhe paga jubilarë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën II të dispozitivit, është e pabazuar, *sepse:*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, ankuesit kanë kërkuar kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shpërblimit jubilar, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesit në ankesë i referohet Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.23/2013 për Pagat, Shtesat dhe Dobitë tjera të Punonjësve në Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

Lidhur me këtë ankuesit ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër përgjigjes së datës 24.12.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili ka theksuar që ende nuk është kryer vlerësimi i rezultateve në punës për vitin 2021, ndërsa ankuesit në ankesën e tij nuk ka specifikuar se për cilat vite kërkohet kompensimin për pagën e trembëdhjetë siç parashihet me dispozitat të nenit 5 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 23/2013 për Pagat, Shtesat dhe Dobitë tjera të Punonjësve në Inspektoratin Policor, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson së ankesa parashtrohet për çdo veprim apo mos veprim lidhur me të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës, në këtë rast meqë ende nuk ka vlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021 dhe meqë nuk është specifikë periudha që kërkohet të kompensohet, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pretendimin për kompensimin për pagën e trembëdhjetë në këtë kuptim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"* dhe nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative".*

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesve që pretendojnë që të bëhet kompensimi i shpërblimit jubilar sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015, dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, siç përcaktohet: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet",* respektivisht deri më datë 31.12.2017. Mirëpo Oda Ekonomike e Kosovës si partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social dhe njëherit nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje pas datës 31.12.2017, bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji për Shqyrtimin

dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa e ankuesit sipas pretendimeve ankimore është parashkruar, kështu që pretendimi i ankuesit mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.11/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat
- Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Policor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

